

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 28 PRILL 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, që po na ndiqni,

Diskutuam sot në këtë seancë parlamentare disa pika të rendit të ditës, si: raportin vjetor të Komisionerit për të Drejtën e Informimit; raportin vjetor të Entit Rregullator të Energjisë dhe raportin vjetor të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri. Pa dyshim që të gjitha këto janë të nevojshme, pasi janë pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së parlamentit, por duhet theksuar se parlamenti nuk ka si detyrë vetëm të ndërtojë procese mekanike, vetëm të ratifikojë, vetëm të shtypë letër e bojë dhe të vulosë. Shumë nga këto procese janë profesionale.

Gjithashtu, na u paraqit për miratim edhe projektligji “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare””. Nuk është diçka sa për të kaluar radhën, duhen dëgjuar ekspertët, duhen harmonizuar ligjet, në mënyrë që procesi të jetë i lehtë, i kuptueshëm, të mos sjellë paqartësi dhe të përmbushen qëllimet e ligjeve dhe ratifikimeve. Por edhe pse kjo konventë mund të ratifikohet, barrierat në aksesin jo të plotë nga qytetarët apo edhe nga kërkues të ndryshëm ndaj dokumenteve zyrtare, janë të pranishme dhe evidente, kjo më së shumti në hapjen e dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit, ligji i së cilës nuk siguron akses të plotë dhe transparent.

Për Shqipërinë do të vijohet të flitet për mungesë llogaridhënieje, aksesin real dhe transparencë në dokumente zyrtare për t’u përballur me të kaluarën. Krahas kësaj, e cila pa dyshim është shumë e rëndësishme, ne si deputetë dhe parlamentarë po sillemi sikur jemi në normalitet. E në të vërtetë nuk jemi në normalitet, por jemi në emergjencë kombëtare. Dhe është detyrë e këtij parlamenti t’i përgjigjet kësaj emergjence. Cila është emergjenca sot? Pa dashur të dukem sikur po bëj propagandë, dua të them se përpara konventës për aksesin në dokumente zyrtare, duhet të diskutojmë aksesin në disa dokumente, që quhen “listat e borxheve” dhe verësisë nëpër markete dhe dyqane, aty ku qytetarët tanë marrin borxh ushqimet. Kjo është shumë e rëndësishme për t’u diskutuar.

Kjo është, gjithashtu, detyrë parësore e parlamentit. Është detyrë mbi detyrat. Nëse në këtë parlament nuk merremi ditë për ditë dhe jo me kohë të pjesshme me standardin e jetesës së qytetarëve të

Shqipërisë, atëherë çfarë kuptimi ka parlamenti dhe çfarë kuptimi ka të jemi deputetë? Ne jemi këtu për të mbrojtur të drejtat kushtetuese dhe interesat ekonomike të komuniteteve dhe qytetarëve shqiptarë, secili sipas zonës përkatëse elektorale. Nuk duhet ta harrojmë kurrë këtë. Realiteti është aq demoralizues dhe aq i tensionuar, saqë njerëzit marrin borxh ushqimet e shportës. Kjo është emergjenca kombëtare. Ndaj duhet të merremi fillimisht me këtë problem, i cili po zgjerohet dhe po thellohet ditë pas dite, pastaj mund të merremi edhe me çështjet e tjera.

Shqipëria është një vend në zemër të Europës, rrethuar nga vendet e Bashkimit Europian, rrethuar nga një treg i madh, si ai europian, por, në fakt, jemi kaq shumë larg Europës. Jemi aq larg saqë jemi katandisur në nivelin ku njerëzit gjerësisht marrin ushqimet borxh, me listë. Ndoshta shqiptarët nuk e rrëfejnë varfërinë e tyre, sepse u vjen zor dhe kanë sedër. Por po ju them se në të gjithë Shqipërinë, veçanërisht në qarkun e Lezhës, nga i cili unë vij, gjendja është tepër e rëndë. Thënë pak më shqip, njerëzit nuk kanë bukë në shtëpi. Para pak ditësh lartmadhëria e tij ishte në Lezhë, na nderoi me vizitën e tij, por pasi hëngri e piu mirë e mirë, pasi kërcëu dhe u tall me hallexhinjtë e Lezhës, pasi ata u përqaftuan dhe u bekuan nga babai i kombit, u lanë në terrin e varfërisë dhe të mungesës së energjisë elektrike, si në qytetin e Lezhës, edhe disa fshatra përreth, për ditë me radhë.

“Nëse nuk ke ngrënë në Lezhë, s’ke parë gjë akoma”, ishin fjalët e fundit të tij para se të largohej nga Lezha. A i pyete, zoti Rama, ata qytetarë, ata fëmijë, kur i takove, a ishin të ushqyer; sa vakte konsumojnë në ditë, apo me çfarë jetojnë ato familje aq të respektuara të qytetit të Lezhës? Sepse, padyshim, parlamenti, si në kohë krize dhe lufte, duhet ta zgjidhë problemin e bukës, pastaj mund të trajtojmë tema të tjera. Raportoi sot në këtë parlament Instituti për Studimet e Krimeve të së djeshmes dhe shumë mirë bëri, ushtroi një detyrë ligjore dhe kushtetuese. Po krimet e të sotmes, kush do t’i studiojë dhe më pas t’i raportojë krimet e të sotmes? Realitetin e sotëm nuk e studiojmë ne, sepse ne jemi palë politike dhe i mohojmë secili disa nga të vërtetat tona.

Siç studiojmë ne krimet e komunizmit, Departamenti Amerikan i Shtetit na studion të sotmen dhe raporton vit pas viti për të sotmen tonë. Raporti i DASH-it shprehet negativisht për Shqipërinë, negativisht edhe për klimën e biznesit në Shqipëri. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se në Shqipëri është e vështirë të ndërtosh veprimtari biznesi, është e vështirë të krijosh vende pune, të fitosh, dhe të qarkullosh kapital, dhe kur vështirësohet ky proces, thellohet varfëria, sepse nuk mbin vetvetiu varfëria, është rrjedhojë e pengesave kundër biznesit dhe kundër punës. Raporti i DASH-it na thotë se korrupsioni endemik minon shtetin e së drejtës dhe pengon zhvillimin ekonomik. Le të ndalemi pak në këtë pikë.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit na thotë se korrupsioni endemik minon shtetin e së drejtës dhe pengon zhvillimin ekonomik.

Le të ndalemi pak në këtë pikë. Nëse politikanët, ministrat, deputetët, drejtorët e lartë të administratës, grumbullojnë shumë para me korrupsion, ata me paratë e korrupsionit paguajnë media, korrumpojnë gjyqtarë e prokurorë, korrumpojnë policë, pikërisht për të ruajtur sistemin që u lejon të vjedhin vazhdimisht. Dhe kur ndodh kjo, nuk ka drejtësi, sepse drejtësinë e kap ai që ka para dhe ka lidhje korruptive brenda shtetit. Prandaj drejtësia shitet e blihet si plaçkë tregu. Korrupsioni krijon grupe politikofinanciare, me lidhje brenda shtetit, me akses në media, të cilët kanë aq shumë fuqi sa për të shkelur të drejtat e njerëzve dhe duke krijuar tension social, depresion ekonomik, mungesë perspektive e mundësie, shpopullim dhe rritje të kriminalitetit.

Kjo është e rrezikshme edhe në planin e sigurisë kombëtare. Prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania dhe të gjitha vendet perëndimore, kanë shpallur shtetin e së drejtës, si garanci dhe siguri, kurse korrupsionin e kanë shpallur si rrezik për sigurinë e popujve. Është korrupsioni që pengon zhvillimin ekonomik, sepse atë pasuri që i takon popullit, njerëzve, qytetarëve, e grabisin politikanët dhe zyrtarët e korruptuar. Kështu, pasuria e qytetarëve pakësohet, ndërsa pasuria e grupeve politiko-financiare vetëm shtohet. Sipërmarrjet e reja, përpara se të paguajnë rrogat e punëtorëve apo të përdorin paratë për investim të ri, duhet të paguajnë këstin dhe gjobën të zyrtarët e korruptuar. Kjo është një ndër shumë pengesat.

Ndaj sot Shqipëria konsiderohet si një nga vendet më të korruptuara në Europë, me një qeveri të korruptuar në të gjitha nivelet. Mirëpo Kryeministri as nuk reflekton, as skuqet e as zverdhet, përkundrazi e shpall raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit si kopje të raporteve të viteve të tjera. Edhe nëse është kopje e raporteve të tjera, do të thotë se nuk ka ndryshuar asgjë nga njëri vit në tjetrin. Jemi po njëjloj, po aq të korruptuar e po aq të varfër.

Të nderuar kolegë,

Asgjë nga çfarë përmenda më lart nuk është abstrakte. Janë shkaqet e vërteta të kësaj gjendjeje ku ndodhemi. Krahas këtyre shkaqeve, shtohet edhe spekulimi me çmimet. Përdorin situatën e luftës në Ukrainë për të zhvatur shqiptarët. Sapo marrin vesh se do të ketë rritje çmimesh, i rrisin çmimet ende pa u furnizuar me mallin me çmim të rritur. E nëse në vendet e tjera europiane në raste krizash njerëzit dhe qeveritë kufizojnë luksin, në Shqipëri kufizojnë bukën, vajin, sheqerin, domaten, vezën dhe të gjitha produktet ushqimore. Pastaj vjen në skenë qeveria, e cila krijon komitetet e çmimeve. E si mund të

menaxhohen çmimet me komitete për çmimet? Çmimet menaxhohen duke forcuar prodhimin vendas në sektorët e bujqësisë, blegtorisë dhe agrokulturës.

Nëse rritet prodhimi vendas, nëse shumica e mallrave të këtyre sektorëve nuk janë mallra importi, por prodhohen në vendin tonë, çmimet do të jenë më të lira, sepse kostot do të jënë më të ulëta e nuk do të prekemi edhe aq shumë nga zhvillimet në vende të tjera. Në të njëjtën kohë, paratë e blerësit dhe konsumatorit shqiptar, nuk do të shkojnë në vende të tjera, por do të mbeten në Shqipëri dhe do të qarkullojnë brenda Shqipërisë, në duart e shqiptarëve. Kjo do të ishte politika më e mirë dhe më e përshtatshme për krizën. Komitetet për çmimet janë tallja me e mirë, por jo politika më e mirë. E nëse flasim si deputetë të parlamentit, si të mandatuar për të mbrojtur interesat e popullit shqiptar, duhet të flasim me zemër në dorë, duke lënë mënjanë interesin personal. Faleminderit!